

SYLLABUS
“METODOLOGJIA E HULUMTIMEVE”
Viti akademik 2021-2022

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës
Titulli i kursit:	Metodologjia e hulumtimeve
Niveli:	Master
Statusi kursit:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet nga dekanati në fillim të vitit</i>
Mësimdhënësi i kursit:	Prof.dr. Avdullah Hoti
Detajet kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, Kati VI, kabineti 75 Email: Avdullah.Hoti@uni-pr.edu Konsultimet: <i>caktohen në fillim të semestrit</i>
Përshkrimi i kursit	<p>Ky kurs përfshin ligjërata dhe ushtrime lidhur me aplikimin e metodave kuantitative dhe kualitative në hulumtime shkencore. Përmes këtij kursi studentët njihen me bazat konceptuale të hulumtimit (konceptet, definicionet, teoritë dhe modelet), metodologjitë dhe strategjitë hulumtuese, llojet e të dhënave dhe analizën e tyre, mostrimin, anketimin dhe dizajnimin e instrumenteve hulumtuese (pyetësorë të strukturuar, gjysmë të strukturuar, etj.), parashtrimin e hipotezave dhe formulimin e problemit hulumtues dhe përzgjedhjen e metodës adekuate hulumtuese për testimin e hipotezave. Po ashtu, në këtë kurs studentët njihen me treguesit kryesorë statistikorë dhe aplikimin e tyre në kuadër të hulumtimeve shkencore.</p> <p>Duke pasur parasysh se hulumtimet dhe analizat kanë vlerë vetëm nëse shtjellohen dhe paraqiten në formë të qartë e mirë të strukturuar, studentët do të njihen me qasjen dhe rregullat e të shkruarit akademik, si dhe me elementet kryesore dhe rregullat për temën e masterit.</p>
Qëllimet e kursit:	Qëllimi i këtij kursi është t’i pajisë studentët me njohuri dhe shkathtësi për hulumtime shkencore. Në veçanti, kursi ka për qëllim të përgatisë studentët lidhur me aplikimin e metodave kuantitative dhe kualitative në hulumtime, si dhe të ofrojë njohuri mbi shkrimin akademik, si dhe standardet dhe struktura e punimit shkencor.

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) të zotërojnë dhe të jenë në gjendje të zbatojnë metodat kuantitative dhe kualitative në hulumtime shkencore, (ii) të konceptojnë, dizajnojnë, organizojnë dhe zhvillojnë një hulumtim shkencor të pavarur (përfshirë zhvillimin e instrumenteve hulumtuese, si pyetësorë për hulumtime, teknikat e mostrimit etj.), (iii) të analizojnë të dhënat dhe rezultatet e hulumtimit duke përdorur treguesit statistikorë dhe ekonometrik, (iv) të zbatojnë standardet e shkrimit akademik në hulumtimet e tyre. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë në javë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	12	24
Seminare	2	3	6
Testet			0
Zhvillimi i punimit seminarik	4	4	16
Punë e pavarur e studentit (në bibliotekë, shtëpi)			142
Përgaditjet për provimin final	3	4	13
Totali			200
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Mësimdhënia organizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve, duke aplikuar diskutim interaktiv, grupe punuese, seminare, prezentime dhe ushtrime.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Për të marrë vlerësim pozitiv në këtë kurs, studenti duhet të demonstrojë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) është i familjarizuar me specifikat e metodologjisë standarde të kërkimeve shkencore, (ii) mund të aplikojë këtë metodologji në hulumtime shkencore dhe (iii) mund të aplikojë rregullat e shkrimit akademik në hulumtime shkencore. <p>Provimi në kudër të këtij kursi është individual dhe konsiston në një punim që studentët e punojnë në klasë, duke u koncentruar në këto çështje:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Arsyeshmëria e hulumtimit: qëllimi dhe propozimet e mundshme që mund të rezultojnë nga ky hulumtim. (ii) Metodologjia hulumtuese: qasja metodologjike në hulumtim, metoda më adekuate dhe arsyeshmëria e 		

	përzgjedhjes së metodës së caktuar dhe (iii) Të dhënat: analiza e mostrës, madhësia e saj dhe treguesit statistikor të dhënat e grumbulluara.
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Research methods for Business Students, Saunder, M., Lewis, P. And Thornill, A., Pearson Education Limited, Essex, 2009 2. Presenting Numbers, Tables, and Charts, Bigwood, S. and Spore, M., Oxford University Press, 2003 3. Si të Shkruajmë: Procesi dhe Shkrimet Funktionale, Boce, E. Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë 2004 4. Si të Shkruajmë Ese, Boce, E., Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2004 5. Si të Shkruajmë Një Punim Kërkimor, Boce, E, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2004
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Statistics for Business and Economics, Kohler, H., Thomson Learning, 2002 2. Si të Shkruhet Vepra Shkencore, Shamiq, M., Logosa, Focus Shkup, 2006 3. Essentials of Research Design and Methodology, Marczyk, G., DeMatteo, D. and Festinger, D., John Wiley & Sons, Inc., 2002 4. Quantitative Methods for Business, Management and Finance, Swift, L. and Piff, S., Palgrave Macmillan, New York, 2005 How to Write Great Essays, Tarkey, L., Learning Express, LLC, New York, 2004
Plani i mësimimit	
Java	Ligjërata
Java e parë:	Hyrje në metodologjinë hulumtuese: Konceptet, definicionet, teoritë dhe modelet
Java e dytë:	Definimi dhe testimi i hipotezave hulumtuese
Java e tretë:	Sigurimi i të dhënave: përcaktimi i mostrës, dizajnimi i pyetësorëve dhe teknikës së mbledhjes së të dhënave
Java e katërt:	Anketimi: metodologjia, databaza dhe inspektimi i të dhënave, gabimet gjatë grumbullimit të të dhënave
Java e pestë:	Analiza e të dhënave: treguesit kryesorë statistikorë, problemet e shkaktuara nga mos-përgjigjet në pyetje, teknikat e identifikimit të problemeve me të dhëna
Java e gjashtë:	Diskutime/seminare
Java e shtatë:	Përgatitja e raporteve me të dhëna statistikore
Java e tetë:	Metodat kualitative: konceptet, definicionet, teoritë
Java e nëntë:	Metodat kualitative: përcaktimi i rasteve për hulumtim, përgatitja e pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupe,

	studimet e rastit
Java e dhjetë:	Raportimi i të dhënave nga analizat kualitative
Java e njëmbëdhjetë:	Disa modele kuantitative ekonometrike: OLS, Probit/Logit, Ordered Probit, Interval Regression
Java e dymbëdhjetë:	Shkrimi akademik: rregullat kryesore, struktura e një shkrimi akademik, organizimi i punimit akademik, ndërtimi i argumenteve, vështrimi kritik mbi literaturën ekzistuese, nxjerrja e përfundimeve, plagjarizmi në punime shkencore
Java e trembëdhjetë:	Rregullat për përgatitjen e punimit shkencor
Java e katërbëdhjetë:	Rregullat për përgatitjen e tezës master
Java e pesëmbëdhjetë:	Diskutime/seminare
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Pjesëmarrja në ligjëratave dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentet inkurajohen të përcjellin diskutimet publike dhe të hapin diskutime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve lidhur me to. Studentët duhet të respektojnë institucionin dhe rregullat akademike, orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe të jenë të angazhuar gjatë zhvillimit të orës mësimore. Është e obligueshme posedimi i ID-së në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studentët duhet tu përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi lidhur me rregullat akademike për realizimin e hulumtimit.</p>	